

 TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. I/89
Dt. 30.04.2015
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje



trainkos

UDHËZIM

**MBI PROCEDURAT E TËRHEQJES DHE VENDOSJES SË
VAGONËVE NË BINARËT INDUSTRIAL**

FUSHË KOSOVË

Prill 2015

Në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit 04/L-111 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP, Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës -TRAINKOS- SH.A. në Mbledhjen Nr. 53 të mbajtur më datë 30.042015, miraton këtë:

UDHËZIM

MBI PROCEDURAT E TËRHEQJES DHE VENDOSJES SË VAGONËVE NË BINARËT INDUSTRIAL

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Në këtë Udhëzim më për së afërmi rregullohet mënyra e vendosjes dhe tërheqjes së vagonëve, në dhe nga binarët industrial , masat e sigurisë dhe mënyra e pranim – dorëzimit të tyre në Hekurudhat e Kosovës -TRAINKOS- SH.A.

Neni 2

Vendosja dhe tërheqja e vagonëve në binarët industrial

Hekurudhat e Kosovës - Trainkos- SH.A. përveç që mund të realizojnë transportimin e mallrave nga importi, eksporti dhe ai vendor po ashtu mund të bëjnë edhe vendosjen – tërheqjen e vagonëve të ngarkuar dhe të zbrazët në binarët industrial të cilët mund t'i posedojnë kompanitë e ndryshme në qoftëse se këta binar industrial lidhen me linjat tona hekurudhore.

Vendosja – tërheqja e vagonave në binarët industrial bëhet paraprakisht në bazë të lidhjes së marrëveshjes – kontratës e cila duhet të lidhet në mes të Hekurudhave të Kosovës – Trainkos SH.A. dhe klientit.

Pas kërkesës me shkrim të cilën duhet ta bëjë klienti për këtë shërbim ndaj Hekurudhave të Kosovës – Trainkos- SH.A. personi përgjegjës nga Trainkos SH.A. duhet të kërkojë dhe të marrë me shkrim konfirmimin nga Infrakos SH.A. për binarin industrial në fjalë se a është në gjendje të rregullt teknike.

Me konfirmimin nga Infracos SH.A. se binari është në gjendje të rregullt teknike dhe se mund të transportohet Hekurudhat e Kosovës – Trainkos- SH.A. mund të nënshkruaj marrëveshjen – kontratën me klient.

Neni 3

Procedura e vendosjes dhe tërheqjes së vagonëve në binarët industrial

Pas realizimit të transportit të mallrave deri në stacionin destinues dhe pasi që të kryhen të gjitha formalitetet e zhdoganimit dhe pagesat tjera, duhet të hartohet orari i manovrimit me të cilin kërkohet vendosja – tërheqja e vagonëve në binarë industrial.

Para nisjes së trenit (vargut manovruar) duhet të kontaktohet personi i autorizuar i klientit i cili duhet të informohet për nisje të trenit.

Për çdo binar industrial hapet enkas libri i pranim – dorëzimit të vagonëve Vag – 4 i cili ruhet te depoisti i vagonëve në stacionin fundor, i njëjti plotësohet para nisjes së trenit dhe pastaj i dorëzohet Udhëheqësit të trenit. Pasi të kryhet pranim dorëzimi i vagonëve libri Vag – 4 i kthehet stacionit nga i cili është marrë.

Pranim - dorëzimi i vagonëve në mes të udhëheqësit të trenit-ndihmës, makinistit dhe personit të autorizuar nga klienti bëhet konform rregulloreve dhe udhëzimeve të aplikueshme në Hekurudhat e Kosovës – Trainkos- SH.A.

Vërejtjet eventuale shënohen në librin e pranim – dorëzimit, pastaj Sektori i transportit të mallrave në marrëveshje me klientin (nëse e shohin të nevojshme) duhet të formojë komision të veçantë për konstatimin e gjendjes faktike.

Pas shkarkimit personi i autorizuar i klientit përmes telefonit e konfirmon shkarkimin e vagonëve të kalkulanti dhe të dispeçeri i vagonëve pastaj dispeçeri i vagonëve planifikon tërheqjen e tyre me lokomotivë dhe personel manovruar.

Neni 4

Dispozitat e përgjithshme dhe shënimet teknike

Për çdo binar industrial është i hartuar Udhëzimi i veçantë i cili është pjesë përbërëse e OLT-së.

Në rastet kur nuk është dhënë udhëzimi në OLT për ndonjë binar atëherë me kërkesë nga Hekurudhat e Kosovës -Trainkos- SH.A. Infracos SH.A. do të ofrojë me shkrim udhëzimin i cili ka të bëjë me dispozitat e komunikacionit dhe shënimet teknike për binarin industrial në fjalë sipas të cilit do të veprojë.

Neni 5

Llogaritja – kalkulimi për vendosjen e vagonëve në binarët industrial

Duke marrë *parasysh* se binarët industrial dallojnë, varësisht nga vendi i degëzimit - nga stacioni ose segmenti i vijës së hapur hekurudhore dhe gjatësisë së tyre, përkohësisht caktohet pagesa shtesë për vendosjen e vagonëve për ngarkim/shkarkim në vijat hekurudhore të binarëve industrial:

Kalkulimi/llogaritja për vendosjen e vagonëve në binarët industrial bëhet nga kalkulanti sipas tabelës tarifore Neni 6 nga Rregullorja mbi përcaktimin e kriterëve për kontratë dhe kushtet e transportit nr. 324 të datës 29.12.2014.

Neni 6

Dispozitat përfundimtare

Më këtë udhëzim do të njoftohen: Sektori i Transportit të Mallrave, Njësia e Komerciales, Zyra e Kontrollit, sigurisë dhe kualitetit, Departamenti i Financave, Kalkulantet Miradi, Sektori i Marketingut.

Ky Udhëzim do të aplikohet pas miratimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve dhe do të vlejë deri me shfuqizimin e tij.



Heset Cakolli

Kryesues i Bordit të HK-Trainkos- SH.A.